



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 21 korrik 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë **“D I E Z E L A” sh.p.k.**

heqjen e pezullimit të afatit të vendimmarrjes për shoqërinë **“BUSHTRICA 2017” sh.p.k.**, pas depozitimit të dokumentacionit plotësues në kuadër të procedurës së licencimit;

zgjatjen e afatit të vendimmarrjes me 30 ditë për kërkesat për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërive:

“ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, me kapacitet të instaluar 10 MW;

“BUSHTRICA 2017” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Bushttrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushttrinë, Qarku Elbasan;

Fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë **“SPV BLUE 2” sh.p.k.** për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, për rritjen e kapacitetit të instaluar nga 50 MW në 100 MW, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 19.06.2026, dhe për shtimin e veprave ndihmëse në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit;

Pezullimin e afatit të vendimmarrjes për kërkesat e shoqërive **“ERSEKA SOLAR PARK 1” sh.p.k.**, **“ERSEKA SOLAR PARK 2” sh.p.k.**, **“GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” sh.p.k.**, **“IDI 2005” sh.p.k.**, **“POWER ENERGY” sh.p.k.**, **“SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k.** dhe **“GREENSOL” sh.p.k.**, lidhur me modifikimin e licencave të prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaiike respektive, për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencave përkatëse, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centraleve.

Pezullimi i afatit të vendimmarrjes për këto kërkesa do të vijojë deri në marrjen e interpretimit/sqarimit të nevojshëm për çështjen objekt shqyrtimi, por në çdo rast jo më shumë se afati fillestar i vendimmarrjes i parashikuar për këto procedura.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.